
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: VIZION PLUS SHPK me adresë në Gjakovë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	29.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **29.04.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **VIZION PLUS SHPK** me adresë në **Gjakovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **VIZION PLUS SHPK** me adresë në **Gjakovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **23.04.2024**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave, pika II. *Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do te beje publikimin e Njoftimit për korrigjim te gabimeve, duke përdorur formularin B54*
- III. **Vërejtje:** Komuna do të bëjë korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik **për Pretendimet ankimore qe janë pjesërisht të bazuar.**
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **VIZION PLUS SHPK** me adresë në **Gjakovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **23.04.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **29.04.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 9.1&9.2, konkretisht tek pika

2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 8 vite pas diplomimit, duhet të jetë

- Certifikatë si ekspert i sigurisë dhe shëndetit ne punë,

- Të jetë i certifikuar si instruktor ne vendin e punës nga oda ekonomike e Kosovës,

- Te jete i certifikuar si Auditor i Brendshem për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit ne punë,

- Të jetë i certifikuar si përgjegjës per sigurimin dhe kontrollin e mjedisit;

Pra kjo kërkesë e AK Komuna Rahovec është kërkesë diskriminuuese dhe favorizuese me qëllim që të kufizohet konkurrenca kjo kuptohet nga certifikimet e kerkura ku ketu diskriminohen shum inxhiner të zotë të cilët janë të aftë të udhëheqin aktivitet te njejta e sidomos te Certifikimi “- *Të jetë i certifikuar si instruktor ne vendin e punës nga oda ekonomike e Kosovës*” ku ta kushtëzon se duhet patjeter te jete i certifikuar nga **Oda ekonomike e Kosovës**, andaj kërkojme nga AK Komuna e Rahovecit qe ta ndryshoj kete kriter sepse nuk jane te nevojshme te gjitha keto certifikime per tipin e punës.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2):

Në Vend të:

2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 8 vite pas diplomimit, duhet të jetë

- **Certifikatë si ekspert i sigurisë dhe shëndetit ne punë,**
- **Të jetë i certifikuar si instruktor ne vendin e punës nga oda ekonomike e Kosovës,**
- **Te jete i certifikuar si Auditor i Brendshem për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit ne punë,**
- **Të jetë i certifikuar si përgjegjës per sigurimin dhe kontrollin e mjedisit;**

Ne bazë të Konsultimeve me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, kërkesa juaj Aprovohet e bazuar dhe kriteri:

Me formular B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara,

Korrigjohet në:

2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 8 vite pas diplomimit, duhet të jetë

- **Certifikatë si ekspert i sigurisë dhe shëndetit ne punë,**
- **Te jete i certifikuar si Auditor i Brendshem për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit ne punë,**
- **Të jetë i certifikuar si përgjegjës per sigurimin dhe kontrollin e mjedisit;**

Për këtë aktivitet te prokurimit nuk do të zbatohet (do të tërhiqet) Kërkesa e më sipërme e Dosjes se Tenderit - (Të jetë i certifikuar si instruktor ne vendin e punës nga oda ekonomike e Kosovës);

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Po ashtu edhe lista e pajisjeve konkretisht tek Numri rendor 8 është kërkuar “**Ngarkuesë**

3/3

F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK

me Zingjirë (Makineri me Strukturë Ngarkuesi me peshe totali mbi 18 ton)”.

Fillimisht kjo makineri nuk është e domosdoshme në këtë aktivitet të prokurimit prandaj duhet të largohet nga lista e makinerisë. Sepse e njejta makineri mund të zevendesohet ose punohet edhe pa zingjir pra Ngarkues me goma e edhe atij mund ti vendosen zingjirë e i cili e kryen te njejten punë. Nga kjo kërkesë kuptohet qartë përshtatja që i është bërë një operatori ekonomik, e ku vetëm emri nuk i është shënuar. Prandaj në këtë rast kërkojmë që të largohet e tëra kjo kërkesë sepse nuk është e nevojshme një makineri e tillë.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Pretendimi ankimor për Pikën 2. te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale gjithashtu nuk qëndron ngase përcaktimi i kësaj për pajisjet dhe mekanizimin, është kërkesë që ka të bëjë lëndën së natyrës së Projektit në fjalë, dhe gjithashtu një kërkesë e tillë është e domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmimeve është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi **në pajtueshmëri me objektin e kontratës. Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave dhe dëshmimeve mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit